



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI**  
**REGULATORNI URED ZA ENERGIJU**  
**ENERGY REGULATORY OFFICE**



# **LICENCË PËR PRODHIM TË ENERGISË TERMIKE**

**DHËNË :**

**“NGROHTORES SË QYTETIT” SH.A.**

**Numri i Licencës: ZRRE/Li\_02/17**

**Prishtinë, 13 prill 2017**

## PËRMBAJTJA:

Neni 1 Qëllimi.....	3
Neni 2 Përkufizimet.....	3
Neni 3 Të drejtat dhe detyrimet .....	5
Neni 4 Llogaritë e Ndara për Aktivitetin e Prodhimit .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
Neni 5 Ndalimi i Ndër-subvencioneve.....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
Neni 6 Ndalimi i Diskriminimit .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
Neni 7 Pajtueshmëria me Kodin e Shpërndarjes, Kodet e Matjes dhe Rregullën për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji.....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
Neni 8 Sigurimi i rezervave të lëndëve djegëse .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
Neni 9 Masat e efijencës së energjisë .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
Neni 10 Shëndeti dhe Siguria .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
Neni 11 Mjedisi .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
Neni 12 Puna .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
Neni 13 Regjistrimi dhe Tjetërsimi i Aseteve Relevante të të Licencuarit ....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
Neni 14 Obligimi i Sigurimit.....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
Neni 15 Ndryshimi në Kontrollin e të Licencuarit .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
Neni 16 Sigurimi i Informacioneve ndaj ZRRE- së .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
Neni 17 Vazhdimi, Modifikimi, Pezullimi, Transferimi dhe Ndërprerja e Licencës.....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
Neni 18 Taksat.....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
Neni 19 Masat Administrative dhe Gjobat.....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
Neni 20 Zgjidhja e Kontesteve.....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
Neni 21 Hyrja në fuqi.....	11

## Neni 1 Qëllimi

1. **Zyra e Rregullatorit për Energji –ZRRE** (në tekstin e mëtejshëm “Rregullatori”), në pajtim me autoritetin e dhënë me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084), Nenin 18 dhe 19 të Ligjit për Energjinë (Ligji Nr. 05/L-081), Nenin 5 të Ligjit për Energji Termike (Ligji Nr. 05/L-052) dhe Rregullën për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë (Rregulla ZRRE/Nr.07/2017), nëpërmjet kësaj në seancën e datës 13 prill 2017 i ndryshon (modifikon) **“Ngrohtores së Qytetit” SH.A (N.Q GJAKOVA) Licencën për Prodhim të energjisë termike** (me numër licence ZRRE/Li\_02/12) **tani me numër licence ZRRE/Li\_02/17, Adresa: Rr.”Tirana”,pn., Gjakovë, Republika e Kosovës** (në tekstin e mëtejshëm “i Licencuari”).
2. Ndryshimi/modifikimi i kësaj licence vjen si rezultat i ndryshimeve të Legjislacionit primar të sektorit të Energjisë: Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084, i cili ka hyrë në fuqi në korrik 2016); Ligjit për Energjinë Termike ( Ligji Nr. 05/L-052, i cili ka hyrë në fuqi në dhjetor 2015); Ligjit për Energjinë (Ligji Nr. 05/L-081, i cili ka hyrë në fuqi në korrik 2016); Ligjit për Energjinë Elektrike (Ligji Nr. 05/L-085, i cili ka hyrë në fuqi në gusht 2016); Ligjit për Gazin Natyror (Ligji Nr. 05/L-082, i cili ka hyrë në fuqi në korrik 2016); si dhe Rregullës për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë (Rregulla ZRRE/Nr.07/2017, e cila ka hyrë në fuqi me 31 mars 2017).

## Neni 2 Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë licencë do të kenë kuptimin si në vijim:
  - a) **“Anëtar”** - marrëdhënia e drejtpërdrejt ose indirekte me të Licencuarin, çdo ndërmarrje Aksionare apo vartës i të Licencuarit, apo ndonjë vartës i një Ndërmarrje aksionare e të Licencuarit, e themeluar sipas legjislacionit në fuqi.
  - b) **“Vit Raportues”** - periudha prej 15 Tetor të vitit aktual deri me 14 Tetor të vitit të ardhshëm.
  - c) **“Energji termike”** – energjia për ngrohjen/ftohjen e hapësirave, ngrohjen e ujit sanitar dhe ujit industrial, që transportohet dhe shpërndahet përmes ujit, avullit, ose gazrave, e përfituar nga stabilimentet e energjisë termike, duke përdorur lëndët djegëse, burimet gjeotermale, energjinë solare, energjinë termike të pashfrytëzuar, me të cilën furnizohen konsumatorët përmes sistemeve qendrore të energjisë termike;
  - d) **“Ngrohje e Përqëndruar”** – energjia termike që transportohet përmes fluidit-bartës të energjisë termike nga prodhuesi deri tek konsumatori, përmes rrjetit të shpërndarjes, për qëllim të ngrohjes së hapësirave të banimit dhe afariste në nivelin e kërkuar, si dhe ngrohjen e ujit sanitar dhe industrial.

- e) **“Rrjeti i shpërndarjes së energjisë termike”** – sistemi i tubacioneve, që transportojnë dhe shpërndajnë energjinë termike nga prodhuesi deri tek nënstacionet termike (prej vendit të matjes së energjisë termike të pranuar, deri tek vendi i matjes së energjisë termike për furnizim respektivisht nënstacionet termike dhe njehsorëve të energjisë termike);
- f) **“Sistemi i energjisë termike”** – sistemi teknik i përbërë nga stabilimente dhe pajisje për prodhimin e energjisë termike, nga instalimet e brendshme dhe të jashtme, që mundësojnë furnizimin me energji termike dhe mund të jetë i pavarur, i mbyllur, ose sistem qendror i energjisë termike;
- g) **“Legjislacion”** - Ligji për Energjinë (Ligji Nr. 05/L-081), Ligji për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-84), Ligjin për Energjinë Elektrike (Ligji Nr. 05/L-085), Ligji për Energji Termike (Ligji Nr. 05/L-052) si dhe çdo legjislacion tjetër primar apo sekondar që rregullon sektorin e energjisë.
- h) **“Kodi i shpërndarjes”** – përmbledhje e rregullave teknike dhe procedurave për operimin, mirëmbajtjen, planifikimin dhe zhvillimin e sistemit të shpërndarjes, si dhe kyçjen në sistemin e shpërndarjes së energjisë termike.
- i) **“Kod i Matjes”** - përmbledhje e rregullave teknike dhe procedurave që përcaktojnë mënyrën e leximit të njehsorëve (matësve), llogaritjes së energjisë së harxhuar, faturimit dhe arkëtimit në sektorin e energjisë termike.
- j) **“Pajisje matëse”** - instrumenti i regjistruar në regjistrin për certifikimin e pajisjeve matëse, të cilat përdoren në procesin e prodhimit dhe të furnizimit me energji termike për ngrohje.
- k) **“Prodhues” apo “Gjenerues”** - personi juridik ose fizik që prodhon (gjeneron) energji termike.
- l) **“Aktivitete të ndara”** - çdo aktivitet tjetër i të licencuarit, i ndryshëm nga ai i aktivitetit të Prodhimit të Energjisë Termike.
- m) **“Furnizim”** - dërgimi, shitja ose rishitja e energjisë termike për ngrohje tek konsumatorët.
- n) **“Prodhim i energjisë termike”** - prodhimi i energjisë termike nga një ndërmarrje e licencuar për këtë aktivitet.
- o) **“Energji termike e pashfrytëzuar”** – energjia termike e prodhuar në impiantet e proceseve teknologjike dhe termocentrale, e cila nuk shfrytëzohet, respektivisht është e humbur, e që me rritje të efijencës së proceseve, ka mundësi të përdoret për ngrohje/ftohje.

2. Shprehjet tjera të përdorura në këtë licencë do të kenë të njëjtin kuptimin si shprehjet e përdorura në Legjislacionin në fuqi.

### **Neni 3** **Të drejtat dhe detyrimet**

1. I Licencuari do të veprojë në pajtueshmëri me Nenet dhe kushtet e përcaktuara në këtë licencë, Ligjin për energjinë termike dhe legjislacionin tjetër në fuqi.
2. I Licencuari do të veprojë si vijon:
  - 2.1 të përdorë gjatë procesit të prodhimit të energjisë termike ato burime primare të energjisë, që ai konsiderohen si më të përshtatshme, me kusht që të jenë në përputhje me karakteristikat teknike dhe kushtet mjedisore (ekologjike) që përfshihen në licencat e tyre dhe në legjislacionin në fuqi;
  - 2.2 të kyçë stabilimentet e prodhimit të energjisë termike në Sistemin e Shpërndarjes sipas kushteve të përcaktuara në Ligjin për energjinë termike, Kodet dhe rregullat përkatëse;
  - 2.3 të lidhë kontrata për shitje të energjisë termike sipas kushteve të Ligjit për Energjinë Termike dhe rregullave të përshkruara nga ZRRE-ja;
  - 2.4 të transportojë energjinë termike përmes sistemit të shpërndarjes;
  - 2.5 të realizojë pagesën e duhur sipas marrëveshjeve.
3. I Licencuari që prodhon energji termike me kapacitet më të madh se 1 MW, është i obliguar të shes energjinë termike të prodhuar tek Furnizuesi Publik sipas dispozitave të Nenit 10 të Ligjit për Energji Termike.
4. Kapaciteti nominal (i instaluar) i njësive për prodhimin e energjisë termike të NQ Gjakova është: Kaldaja 1: 18.6 MW<sub>TH</sub>; Kaldaja 2: 20 MW<sub>TH</sub>.
5. Territori që mbulohet nga kjo licencë është i territori i Komunës së Gjakovës.

### **Neni 4** **Llogaritë e Ndara për Aktivitetin e Prodhimit**

1. I Licencuari do të përgatisë dhe dorëzojë në ZRRE Pasqyrat Financiare Vjetore të audituara nga auditori i pavarur në përputhje me Ligjet vendore në fuqi dhe Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, brenda afateve të përcaktuara me ligjet në fuqi për raportimin financiar.
2. I Licencuari do të përgatisë Pasqyrat Rregullative Vjetore në përputhje me Udhëzimin për Raportimin Rregullativ të Ndërmarrjeve të energjisë termike, nxjerrë nga ZRRE-ja dhe do t'i dorëzojë ZRRE-së një kopje të këtyre pasqyrave, brenda tre (3) muajve pas përfundimit të vitit raportues.

3. I Licencuari në kontabilitetin e tij të brendshëm do të mbajë kontabilitetin (llogari) për aktivitetin Gjenerues në tërësi, ndaras nga aktivitetet tjera dhe duhet t'i dorëzohet ZRRE-së në formën dhe datën e specifikuar nga ZRRE-ja. Kontabiliteti rregullativ do të mbahet në përputhje me Udhëzimin për Raportimin Rregullativ të Ndërmarrjeve të energjisë termike, që ndër të tjerash mund të specifikojnë:
  - 3.1. formën e Pasqyrave / deklaratave rregullative të kontabilitetit, duke përfshirë, por duke mos u kufizuar vetëm në Pasqyrën e të Ardhurave (fitimit/humbjes), bilancin e gjendjes, Pasqyrat e pranura të fitimeve dhe humbjeve, Pasqyrën e rrjedhjes së parave të gatshme dhe bilancin e energjisë termike (ngrohjes), si dhe deklaratat për shumatat e të ardhurave vjetore, kostot, asetet, borxhet, rezervat ose furnizimet, të cilat janë faturuar nga ndonjë aktivitet tjetër, ose janë përcaktuar nga alokimi ose shpërndarja midis aktivitetit gjenerues të konsoliduar dhe ndonjë aktiviteti tjetër.
  - 3.2. natyrën dhe përmbajtjen e Pasqyrave / deklaratave rregullative të kontabilitetit, duke përfshirë informacione mbi lloje të specifikuar të të ardhurave vjetore, shpenzimeve, aseteve ose borxheve, dhe informacione mbi të ardhurat vjetore, asetet, shpenzimet dhe borxhet nga aktivitetet e specifikuar.
  - 3.3. parimet dhe politikat e kontabilitetit rregullativ (duke përfshirë bazat për alokimin e shpenzimeve).
4. Në lidhje me pasqyrat / deklaratat e kontabilitetit rregullativ për sa i përket vitit financiar, i Licencuari nuk do të ndryshojë bazat e tarifimit, shpërndarjes ose alokimit që janë përdorur në vitin financiar paraprak, përveçse nëse ZRRE-ja nxjerr më parë udhëzimet për qëllimet e këtij Neni ose nëse ZRRE-ja jep paraprakisht aprovimin me shkrim për ndryshimin e këtyre bazave.
5. I Licencuari do të veprojë në pajtueshmëri me çdo udhëzim të nxjerrë nga ZRRE-ja dhe legjisllacioni në fuqi.

#### **Neni 5**

#### **Ndalimi i Ndër-subvencioneve**

I Licencuari do të parandalojë apo evitojë që aktiviteti prodhues të japë apo të marrë ndonjë ndër-subvencion (direkt apo të tërthortë) prej ndonjë aktiviteti tjetër të të Licencuarit ose ndonjë Vartësi (ortaku) apo anëtarit ose nga ndonjë person tjetër.

#### **Neni 6**

#### **Ndalimi i Diskriminimit**

1. I Licencuari nuk do të shesë e as do të ofrojë shitjen e energjisë termike ndonjë blerësi ose personi që kërkon të bëhet blerës me çmime të cilat materialisht janë më shumë a më pak të favorshme, se sa ato me të cilat i Licencuari do të shesë ose ofrojë sigurimin e energjisë termike ndaj blerësve të krahasueshëm.

2. I Licencuari në ç'do kohë do t'i raportojë ZRRE-së lidhur me rrethanat e shitjes së energjisë termike ndaj blerësve/shitësve, duke përfshirë (pa kufizim) vëllimin, faktorët e ngarkesës (kapacitetit), kushtet e ndërprerjes, afatet dhe kohëzgjatjen e marrëveshjeve përkatëse.
3. I Licencuari do të dorëzojë në ZRRE informacione rreth:
  - 3.1 furnizimit me energji termike për çdo furnizues; dhe
  - 3.2 furnizimit me energji termike për çdo konsumator tjetër.
4. Furnizimi me energji termike për çdo konsumator do të përfshijë gjithashtu sigurimin e kapacitetit në dispozicion për çdo njësi të prodhimit të energjisë termike.

#### **Neni 7**

#### **Pajtueshmëria me Kodin e Shpërndarjes, Kodi i Matjes dhe Rregullën për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji**

1. I licencuari do të veprojë në pajtueshmëri me dispozitat e Kodit të Shpërndarjes, Kodit të Matjes dhe Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji, si dhe legjislacionin tjetër në fuqi.
2. I Licencuari mund të kërkojë derogim (shtyrje) në zbatimin e atyre dispozitave që nuk është e mundur të zbatohen sipas paragrafit 1 të këtij Neni. ZRRE-ja pas shqyrtimit të kërkesës nga i Licencuari mund të lejojë apo refuzojë derogimin (shtyrjen) e afatit të zbatimit.

#### **Neni 8**

#### **Sigurimi i rezervave të lëndëve djegëse**

1. I Licencuari do të përgatisë planin për rezervat e lëndëve djegëse sipas Nenit 11 të Ligjit për Energjinë Termike si dhe legjislacionin sekondar, të lëshuar nga Ministria përgjegjëse për energjinë.
2. I Licencuari do të veprojë në përputhje me çdo dispozitë që përcakton llojin dhe masën (sasinë) e minimumit të rezervës së lëndëve djegëse (karburantit apo kapaciteteve rezervë) si dhe legjislacionin sekondar të Ministrisë përgjegjëse për energjinë dhe Kodet në fuqi.

#### **Neni 9**

#### **Masat e efijencës së energjisë**

1. Në pajtim me nenin 8, paragrafi 1.1. të Ligjit për energjinë termike i licencuari duhet të merr në konsideratë kërkesat lidhur me efijencën e energjisë termike që janë të përshkruara në Ligjin për Energji Termike, dhe çfarëdo legjislacioni sekondarë të lëshuar nga ZRRE-ja apo Ministria përgjegjëse për energji.

2. Masat për ngritjen e efijencës së energjisë termike gjithashtu duhet të jenë në përputhje edhe me Planin Kombëtar të Veprimit për Efijencën e Energjisë.

#### **Neni 10** **Shëndeti dhe Siguria**

1. I Licencuari duhet të ndërmerr të gjitha veprimet e nevojshme për t'i mbrojtur personat nga lëndimet dhe dëmtimet që mund t'u shkaktohen atyre nga ana e të Licencuari gjatë kryerjes së aktivitetit të Prodhimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
2. I Licencuari në përputhje me legjislacionin në fuqi, do të kryej kontroll (auditim) teknik dhe të sigurisë së kapaciteteve të prodhimit në baza vjetore, dhe rezultatet e një kontrolli të tillë do t'i dërgoi në ZRRE, sa herë që kjo kërkohet nga ZRRE-ja.

#### **Neni 11** **Mjedisi**

1. I Licencuari do t'i dërgojë ZRRE-së kopje të Lejes Ekologjike për Mbrojtjen e Mjedisit dhe dokumentet tjera të lëshuar nga Ministria përkatëse për mbrojtjen e mjedisit. I Licencuari duhet të veprojë në pajtueshmëri me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e mjedisit në Kosovë.
2. I Licencuari do t'i raportojë ZRRE-së për çdo vit mbi aktivitetin e tij mjedisor.

#### **Neni 12** **Puna**

I Licencuari lidhur me marrëdhënien në punë dhe sigurinë në punë do të veprojë në pajtim me legjislacionin në fuqi në Kosovë.

#### **Neni 13** **Regjistrimi dhe Tjetërsimi i Aseteve Relevante të të Licencuarit**

1. I Licencuari do të përgatisë dhe do të mirëmbajë një regjistër për të gjithë asetet relevante dhe do t'ia dorëzojë ZRRE-së këtë regjistër, jo më vonë se 31 Janar të çdo viti.
2. I Licencuari nuk do të shesë apo heqë dorë nga kontrolli funksional mbi ndonjë aset relevant, nëse kjo do të ndikonte në aftësinë e tij për t'i kryer obligimet e tija apo nëse aseti ka vlerën e zëvendësimit mbi njëqindmijë Euro (100,000.00 €).
3. Në rast kur i Licencuari dëshiron të shesë asete apo pasuri tjera që përdoren në ushtrimin e aktivitetit të licencuar, ku vlera e tyre e tejkalon shumë njëqind mijë euro (100,000.00 €), i Licencuari është i obliguar që ta njoftojë ZRRE-në me shkrim dhe kërkon miratimin e ZRRE-së. I Licencuari mund ta bëjë tjetërsimin e ndonjë aseti të tillë vetëm pas miratimit me shkrim nga ZRRE-ja.

4. E njëjta si më paragrafin 2 të këtij Neni aplikohet edhe për dhënien në shfrytëzim të aseteve ose burimeve (resurseve) të tjera që përdoren për të kryer aktivitetin e licencuar.

5. Në këtë Nen:

**“Tjetërsimi”** - çdo shitje, transferim, dhurim, dhënie me qira, hua, hipotekë, ngarkim, kufizim mbi shfrytëzimin (qoftë ky fizik ose ligjor) ose ndonjë pagesë tjetër, si dhe lejim i ndonjë pagese ndaj një aktiviteti tjetër të të Licencuarit dhe/ose një pale të tretë.

**“Aset relevant”** - çdo pajisje dhe çdo pasuri e luajtshme ose e paluajtshme e përdorur nga i licencuari për ushtrimin e aktivitetit të prodhimit të energjisë termike, përfshirë çdo interes ligjor apo të dobishëm për ndonjë tokë apo objekt dhe çdo pronësi intelektuale.

#### **Neni 14 Obligimi i Sigurimit**

1. I Licencuari do të bëjë sigurimin e aseteve në pajtim me legjislacionin në fuqi në Kosovë.
2. I Licencuari do të lidhë kontrata për sigurimin e aseteve të prodhimit dhe për pajisjet që përdoren për prodhim të energjisë termike. Kontrata e tillë do t’i dërgohet ZRRE-së për rishikim në baza vjetore.

#### **Neni 15 Ndryshimi në Kontrollin e të Licencuarit**

1. I Licencuari do të njoftojë ZRRE-në për ndonjë ndryshim që pritet në kontroll të të Licencuarit së paku gjashtëdhjetë (60) ditë paraprakisht. Ndryshimi në kontroll nuk do të jetë efektiv deri sa ZRRE-ja nuk e aprovon.
2. I Licencuari do të njoftojë ZRRE-në për ndonjë ndryshim të Strukturës Organizative të të Licencuarit. Njoftimi i tillë do t’i bëhet ZRRE-së jo më vonë se tre (3) ditë nga data e çdo ndryshimi të tillë.

#### **Neni 16 Sigurimi i Informacioneve ndaj ZRRE- së**

1. I Licencuari do të dorëzojë në ZRRE informacione dhe raporte në mënyrën dhe në afatet që ZRRE-ja mund t’i konsiderojë të nevojshme.
2. Nëse i Licencuari, në përputhje me Rregullën për Informatat konfidenciale kërkon që një informacion i caktuar të konsiderohet si konfidencial atëherë është obligim i tij që të shënjojë atë informacion si konfidencial dhe të arsyetojë kërkesën e tij tek ZRRE-ja. ZRRE do të shqyrtojë kërkesën e tillë në pajtim me Rregullën për Informatat Konfidenciale.

3. ZRRE-ja ka të drejtë të kërkojë nga i licencuari çdo informatë konfidenciale, të nevojshme për përmbushjen e funksioneve dhe detyrave të saj, në pajtim me Nenin 12 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë.
4. I Licencuari duhet të përcaktoj një anëtarë të personelit i cili do të shërbej si pikë kontakti apo referimi për ndërlidhje me ZRRE; ky anëtarë pra do të shërbej si përgjegjës për çështje rregullative.
5. I Licencuari do ti dërgoj ZRRE-së detalet për çdo ndryshim në informata që janë dërguar gjatë aplikimit për këtë licencë.
6. Në këtë Nen

**“Informacion”** – materiali që në çdo formë dhe pa asnjë kufizim do të përfshijë çdo kontratë, libër, dokument, regjistër, llogaritje kontabël (statutore ose tjetër), vlerësim, kthim ose raport të çdo përshkrimi dhe çdo shpjegim (gojor ose me shkrim) në lidhje me këto informacione që mund të jenë kërkuar nga ZRRE-ja.

#### **Neni 17**

##### **Vazhdimi, Modifikimi, Pezullimi, Transferimi dhe Ndërprerja e Licencës**

1. ZRRE-ja mund të vazhdojë, modifikojë, pezullojë dhe ndërpresë këtë licencë në përputhje me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë dhe Rregullën për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë.
2. ZRRE-ja mund të transferojë këtë licencë në përputhje me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë, Rregullën për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë dhe legjislacionin tjetër në fuqi, por duke u siguruar që obligimet e Licencës mund kryhen nga i licencuari tjetër dhe nëse konsumatorët nuk do të dëmtohen (vijjnë në pozitë të vështirë) për shkak të një transferimi të tillë.

#### **Neni 18**

##### **Taksat**

I Licencuari do t'i paguajë ZRRE-së çdo taksë fillestare dhe vjetore të caktuar sipas Rregullës për Taksat, të nxjerrë nga ZRRE-ja.

#### **Neni 19**

##### **Masat Administrative dhe Gjobat**

1. Në rast shkeljeje të dispozitave të Legjislacionit në fuqi përfshirë Rregullat e nxjerra nga ZRRE apo Nenet dhe kushtet e kësaj Licence apo instruksionet e dhëna të Licencuarit nga ana e ZRRE-së, ZRRE-ja ka kompetenca t'i vendos të Licencuarit masa administrative dhe gjoba në përputhje me Nenin 57 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë dhe Rregullën për Masat Administrative dhe Gjobat.

2. Masat administrative dhe gjobat mund t'i vendosen ndërmarrjes si subjekt juridik si dhe personave përgjegjës të ndërmarrjes.
3. Shuma e gjobës do të vlerësohet në pajtim me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë dhe Rregullën për Masat Administrative dhe Gjobat.

## Neni 20 Zgjidhja e Kontesteve

1. Çdo kontest që paraqitet apo është i lidhur me aktivitetet e licencuara do të zgjidhet në përputhje me Rregullën për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë, të nxjerrë nga ZRRE-ja.
2. Vendimet e ZRRE-së në lidhje me vazhdimin, modifikimin, pezullimin, ndërprerjen dhe transferin e licencës si dhe vendimet lidhur me gjobat si rezultat i shkeljeve të kushteve të licencës apo shkeljes së ligjeve të aplikueshme, mund të kontestohen nga i Licencuari në gjykatën kompetente sipas ligjeve në fuqi.

## Neni 21 Hyrja në fuqi

1. Në pajtim me Nenin 36 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, kjo licencë e ndryshuar/modifikuar tani me numër licence ZRRE/Li\_02/17 i lëshohet **“Ngrohtores së Qytetit” SH.A.** për aktivitetin e Prodhimit të Energjisë Termike dhe hyn në fuqi me datë **13.04.2017.**
2. Licenca e lëshuar me datë **04 Tetor 2006** (Nr. i Licencës ERO/Li\_02/06), e modifikuar me 18.07.2012 (Nr. i Licencës ZRRE/Li\_02/12), tani e modifikuar më 13.04.2017 (Nr. i Licencës ZRRE/Li\_02/17) do të vazhdoj të jetë e vlefshme për një periudhë pesëmbëdhjetë (15) vjeçare, deri më **04 Tetor 2020.**

E vulosur me vulën e rëndomtë të Zyrës së Rregullatorit për Energji me datë: \_\_\_\_\_

Nënshkruar (në emër të Bordit të Rregullatorit) U.D Krenar Bujupi: \_\_\_\_\_

Nënshkruar më: 13.04.2017.